



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

NR. 8 DATË 18.01.2013

PËR

**MIRATIMIN E STUDIMIT URBANISTIK PJESOR, ME SIP 1.2 HA, NË ZONËN
TURISTIKE TË GJIRIT TË LALËZIT, ME INVESTITOR SHOQËRINË “PRIMAVERA”
sh.p.k, NË KOMUNËN ISHËM, QARKU DURRËS**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 89 pika 4 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit nr. 87 datë 07.02.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, Vendimit nr. 88, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit” dhe Vendimit nr. 345, datë 09.05.2012 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në Vendimin nr. 502, datë 13.07.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, Këshilli Kombëtar i Territorit

V E N D O S I :

1. Të miratohet Studimi urbanistik pjesor, me sip.1.2 ha, në zonën turistike të Gjirit të Lalëzit, me investitor shoqërinë “Primavera” sh.p.k., në komunën Ishëm, qarku Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet komuna Ishëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SALI BERISHA


ZËVENDËS KRYETAR I KKT

SOKOL OLLDASHI

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT



SEKRETARE E KKT

KREUZA LEKA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

